



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Z. Musa Shabani
Pronar
VISA CHANNEL
OSHP 22
Rr/ Edit Durham nr.10
Mitrovicë
URDHËR:LIC/NKM-2012/04
Ref: 1211/1089/KPM/ni

URDHËR

për revokim dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së OSHP VISA CHANNEL, Mitrovicë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHP VISA CHANNEL është një ofrues i shërbimeve programore i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për të ofruar programe përmes rrjetit kabllor, në pajtim me rregulloren CIMC 2007/04. OSHP VISA CHANNEL është pajisur me licencë të KPM-së më 22 maj 2009.
3. Më 7 dhjetor 2011, KPM është njoftuar zyrtarisht me shkrim nga OSHP VISA CHANNEL, se heq dore nga licenca për ofrimin e shërbimeve programore.
4. Përmes të njëjtës shkresë, OSHP VISA CHANNEL, ka njoftuar se, në mënyrë vullnetare heq dorë nga licenca e KPM-së.

Arsvetimi

5. Me njoftimin e OSHP VISA CHANNEL që në mënyrë vullnetare heq dorë nga licenca e ofruesit të shërbimeve programore, KPM, në pajtueshmëri me Nenin 7.1 të Udhëzuesit të KPM-së në Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarve i cili thotë:

i. "Një i Licencuar që vullnetarisht përfundon operimet e tij dhe njofton për këtë KPM-në do të konsiderohet se vullnetarisht e ka dorëzuar licencën e tij. Me të marrë një njoftim të tillë KPM-ja do ta konsideroj licencën të jetë e pavlefshme dhe të anuluar. Personeli i KPM-së do ta këshilloj Komisionin, i cili do ta lëshoj një Urdhër për Revokim të licencës pa paragjykuar në ndonjë aplikacion të ardhshëm për licencë të cilin i licencuari mund ta paraqes",

6. lëshon urdhër për revokim dhe shpallje të pavlefshme të licencës për OSHP VISA CHANNEL.

URDHËR

7. KPM, lëshon këtë Urdhër për Revokim të Licencës, përmes të cilit e konsideron të pavlefshme licencën për ofrimin e shërbimeve programore të OSHP VISA CHANNEL.

Lëshimi i Urdhërit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni.



Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



15.11.2012
datë